



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
DREJTORIA E BUJQËSISË, PYJEVE, KULLOTAVE DHE UJITJES

Nr. 1669/prot.  
1

Himarë, më 17.02.2025

PROJEKTVENDIM

Nr. 10, datë 17.02.2025

**“PËR MIRATIMIN E LISTËS TË KULLOTAVE TË GATSHME PËR KULLOTJE E KOSITJE  
PËR SEZONIN KULLOSOR, VEROR DHE DIMËROR, PËR VITIN 2025, SI DHE KONTRATËN  
TIP”**

Bazuar në ligjin nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjin Nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, mbështetur në nenin 15 të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007, “Për Fondin Kullor”, i ndryshuar, në VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive” si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr. 2, datë 20.07.2016, “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”, Këshilli Bashkiak Himarë pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Himarë:

**VENDOSI**

1. Të miratojë listën e kullotave të gatshme për kullotje e kositje për sezonin kullor, veror dhe dimëror, për vitin 2025 si dhe kontratën tip, bashkëngjitur.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi drejtoria e bujqësisë, pyjeve, kullotave dhe ujitjes.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 55, pika 6.

**KRYETARI I BASHKISË**

Vangjel Tavo



**DREJTORI**

Ilia Gjika



REPUBLIKAE SHQIPËRISE  
BASHKIA HIMARË  
DREJTORIA E BUJQËSISË, PYJEVE, KULLOTAVE DHE UJTJES

Nr. 1669/prot.  
2

Himarë, më 21.02.2025

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Himarë

RELACION

I nderuar Kryetar i Këshillit, të nderuar këshilltarë;

Bazuar në ligjin nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, mbështetur në nenin 15 të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007, “Për Fondin Kullor”, i ndryshuar, në VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive” si dhe të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr. 2, datë 20.07.2016, “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”, kreu II, “Procedurat e dhënies për kullotje dhe kositje bari”, pika 2. “Në përputhje me kërkesat e pikës 1 të këtij kreu, struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki, në muajin shkurt të çdo viti, pas miratimit të listës në këshillin bashkiak, të kullotave të gatshme për kullotje e kositje për sezonin përkatës e shpall atë, .....

”, i kërkojmë Këshillit Bashkiak Himarë të shqyrtoj materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Himarë dhe të miratojë listën e kullotave të gatshme për kullotje e kositje për sezonin kullor, veror dhe dimëror, për vitin 2025 si dhe kontratën tip, bashkëngjitur.

KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E BUJQËSISË, PYJEVE, KULLOTAVE DHE UJITJES

Nr. \_\_\_\_ prot

Himarë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2025

MIRATOI  
KRYETARI I BASHKISË  
Vangjel Tavo

### KONTRATË QIRAJE

### PËR DHËNIEN E KULLOTAVE DHE LIVADHEVE PËR KULLOTJE E KOSITJE BARI

Sot më datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2025, në zbatim të neneve 659 e vijues, 801 e vijues dhe 826 e vijues të ligjit nr. 7850 datë 29.07.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe mbështetur në nenin 15 të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007, "Për Fondin Kullosor" i ndryshuar, në VKM nr. 433 datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive", në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 54, datë 25.11.2021 "Për paketën fiskale të vitit 2022, Bashkia Himarë", Udhëzimin e Ministrisë së Mjedisit nr. 2 datë 20.07.2016, "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënie të tyre për kullotje e kositje bari", Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr. \_\_\_\_ , datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2025, Vendimit nr. \_\_\_\_ , datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2025, të Kryetarit të Bashkisë si dhe kërkesës nr. \_\_\_\_ prot., datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 202\_\_ , lidhet kjo kontratë mes:

#### **PALËVE:**

1. Bashkia Himarë, përfaqësuar nga drejtori i drejtorisë së bujqësisë, pyjeve, kullotave dhe ujitjes z. Ilia Gjika, i cili në këtë kontratë është «Qiradhënësi».
2. Person juridik/fermer fizik, përfaqësuar nga z. \_\_\_\_\_, i cili në këtë kontratë është «Qiramarrësi».

### **DISPOZITA TË PËRGGJITHSHME**

#### **Neni 1**

#### **Objekti i kontratës**

1. Qiradhënësi i jep me qira për kullotje/kositje bari/krasitje gjethi, për ndërtime provizore qeramarrësit, z. \_\_\_\_\_ kullotën që ndodhet në ekonominë pyjore/kullosore " \_\_\_\_\_ ", në ngastrën Nr. \_\_\_\_\_ , me emërtimin \_\_\_\_\_ sipërfaqe \_\_\_\_\_ ha, dhe me kapacitet mbajtës prej \_\_\_\_\_ krerë, sipas vendimit, bashkëlidhur harta.

#### **Kufizohet:**

Në veri: \_\_\_\_\_

Në jug: \_\_\_\_\_

Në lindje: \_\_\_\_\_

Në perëndim: \_\_\_\_\_

## Neni 2 Afati i Kontratës

1. Afati i kontratës është për \_\_\_\_ (\_\_\_\_) vjet me të drejtë ripërsëritje.  
Afati i përdorimit të kullotës fillon më datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2025 dhe përfundon më datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .202\_\_ .  
Efektet financiare të saj fillojnë nga data e lidhjes së kontratës midis palëve.

## Neni 3 Vlera vjetore e qirasë

1. Vlera vjetore e qirasë për përdorimin e kullotave është llogaritur sipas tarifave të miratuara nga V.K.M nr. 632, dt. 11.06.2009 dhe nga Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 54, datë 25.11.2021 "Për paketën fiskale të vitit 2022, Bashkia Himarë", si më poshtë:

- Për të imta \_\_\_\_ krerë x 150.0 Lekë/krerë = \_\_\_\_\_ Lekë.
- Për të trasha \_\_\_\_ krerë x 1000.0 Lekë/krerë = \_\_\_\_\_ Lekë.

Shuma: \_\_\_\_\_ ( \_\_\_\_\_ ) Lekë.

2. Vlera vjetore e qirasë për kositje bari/krasitje gjithi është llogaritur sipas tarifave të miratuara nga V.K.M nr. 632, dt. 11.06.2009 dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 54, datë 25.11.2021 "Për paketën fiskale të vitit 2022, Bashkia Himarë" si më poshtë:

- Kositje bari \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup> x \_\_\_\_\_ Lekë/ m<sup>2</sup> = \_\_\_\_\_ Lekë.
- Krasitje gjithi, drurë \_\_\_\_\_ m<sup>3</sup> x \_\_\_\_\_ Lekë/ m<sup>3</sup> = \_\_\_\_\_ Lekë.

Shuma: \_\_\_\_\_ . ( \_\_\_\_\_ ) Lekë.

3. Vlera vjetore e qirasë për përdorimin e tokës për ndërtime provizore, është llogaritur sipas tarifave të miratuara nga V.K.M nr. 632, dt. 11.06.2009, dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 54, datë 25.11.2021 "Për paketën fiskale të vitit 2022, Bashkia Himarë" si më poshtë:

- Qendër stani e rrethuar, \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup> x \_\_\_\_\_ Lekë/m<sup>2</sup> = \_\_\_\_\_ Lekë.
- Qendër përpunim bulmeti, \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup> x \_\_\_\_\_ Lekë = \_\_\_\_\_ Lekë.
- Ngrehinë banimi për barinj, \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup> x \_\_\_\_\_ Lekë/m<sup>2</sup> = \_\_\_\_\_ Lekë
- Mullinj, magazinë, \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup> x \_\_\_\_\_ Lekë/m<sup>2</sup> = \_\_\_\_\_ Lekë.

Shuma: \_\_\_\_\_ lekë. ( \_\_\_\_\_ ) Lekë.

GJITHSEJ :

(shuma 1+2+3) ( \_\_\_\_\_ ) Lekë.

## Neni 4 Pagesa

1.

Pagesa e qirasë bëhet vjetore, përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit nr. 2 datë 20.07.2016, kreu i dytë, dhe do të kryhet pranë çdo banke për llogari të Bashkisë Himarë në numrin e llogarisë: 902427125000019008, IBAN:AL43902265404271250000190089.

## **TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QERADHENESIT**

### **Neni 5**

1. Qiradhënësi detyrohet ti dorëzojë qiramarrësit, menjëherë mbas lidhjes së kësaj kontrate, hartën me kufijtë e sipërfaqes që do të përdoret për kullotje.
2. Ti caktoje në vend, në rast se ka, ngastrat që do të përmiresohen dhe ngastrat eksperimentale, që sipas udhezimit nuk lejohen të kullohen. Në këto ngastra do të mbahen proces-verbale me kufij të qartë.
3. T'i dorëzojë qeramarrësit veprat e ujit dhe objektet e tjera nëse ka në shërbim të kullotjes me kapacitetin e plotë të tyre.
4. Dorëzimi bëhet me proces-verbal midis subjektit dhe inspektorit të kullotave direkt në objekt, pas nënshkrimit të kësaj kontrate.
5. Qiradhënësi ushtron kontrolle në çdo kohë mbi zbatimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e qiramarrësit dhe mbi pasurinë e dhënë me qira për të përcaktuar nëse qiramarrësi respekton detyrimet kontraktore, si dhe ato detyrime që dalin për qiramarrësin sipas natyrës dhe rregullave agroteknike të përdorimit të objektit të kontratës. Në çdo kontroll, qiradhënësi mban një proces-verbal dhe i kërkon qiramarrësit riparimin e shkeljeve e të dëmeve të konstatuara.
6. Qiradhënësi nuk përgjigjet për pretendimet e tjera që nuk kanë të bëjnë me objektin dhe qëllimin e kësaj kontrate.

## **TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QIRAMARRËSIT**

### **Neni 6**

1. Mbas nënshkrimit të kësaj kontrate qiramarrësi merr në dorëzim me proces-verbal kullotën/livadhin sipas kufijve të hartës, lerat për ujë të pijshëm për blektorinë dhe objektet e tjera në shërbim të kullotjes. Në rast dëmtimi të tyre, detyrohet t'i riparojë pa pagesë.
2. Qiramarrësi ka të drejtë të mbajë në kullotë bagëtitë e tij, vetëm sipas aftësisë mbajtëse të kullotës dhe të zbatojë rregullat për përdorimin e kontrolluar të kullotës.
3. Të kryej pa shpërbim zbrazjen e lerës, nëse ka (kur ajo është me saraçineskë), pastrimin e saj dhe pastaj të bllokojë rrjedhen e ujit, për t'u mbushur për sezonin e ardhshëm në prani të inspektorit të zonës.
4. Të marrë të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e kullotave nga zjarret dhe në rast zjarri të marrë pjesë në fikjen e tij.
5. Të zbatojë të gjitha rregullat e shërbimit veterinar dhe shëndetësor.
6. Të paguaj vlerën e qirasë sipas kritereve të përcaktuara në nenet 3 dhe 4 të kësaj kontrate në ditën dhe në vendin e caktuar më sipër.
7. Të lehtësojë kontrollet që mund të kryhen nga Policia Pyjore, për përdorimin e kullotës së marrë me qera.
8. Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë me qira kullotën apo livadhin objekt të kësaj kontrate, apo të bëjë nënkontraktime me subjekte të tjera, ose t'ia kalojë kontratën e lidhur një subjekti tjetër pa miratimin zyrtar të qeradhënësit (Bashkisë).
9. Në përfundim të afatit kontraktor, qiramarrësi i dorëzon qiradhënësit me proces-verbal të mbajtur direkt në objekt, sipërfaqen objekt të kontratës.
10. Nëse qiramarrësi ka plotësuar të gjitha detyrimet deri në përfundim të afatit 6 mujor të kontratës, palët bisedojnë për të rishikuar mundësinë e zgjatjes së kontratës deri në lidhjen e një kontrate të re.
11. Qiramarrësi ka për detyrë ruajtjen e parcelës që ka kontratuar, nga prerjet e druve nga persona të tjerë për qëllim tregëtie dhe ç'do qëllim tjetër.
12. Qiramarrësi ka për detyrë ruajtjen e parcelës që ka kontratuar nga kultivimi i lëndëve narkotike, në rast se konstatohet kultivimi i lëndëve narkotike nga qiramarrësi ose persona të tjerë në sipërfaqen e kontraktuar, qiramarrësi mban përgjegjësi penale.

## ZGJIDHJA E KONTRATËS

### Neni 7

1. Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit si dhe me marrëveshje midis palëve.
2. Kontrata mund të zgjidhet edhe përpara mbarimit të saj, kur janë shkelur dhe nuk janë respektuar kërkesat e saj nga secila palë. Konkretisht, qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kësaj kontrate, kur qiramarrësi nuk ka shlyer vlerën e qirasë sipas kushteve të kontratës, dëmton ose nuk mirëmban kullotën/livadhin ose veprat ujëpëruese për blektorinë (lera, çezma, etj.) që ka marrë në përdorim, nuk përmbush detyrimet e tjera që rrjedhin nga kontrata. Njoftimi për zgjidhjen e kontratës bëhet me shkrim 15 ditë përpara zgjidhjes së kontratës.
3. Për shkeljen e kushteve kontraktore kur ato janë parashikuar si kundravajtje administrative sipas nenit 34 të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 "Për fondin kullësor", ndaj qiramarrësit vendosen sanksionet e parashikuara nga ky nen.
4. Në rast se kullota digjet, qiramarrësit i humbet e drejta e përdorimit dhe trajtimit me kullotë për 3 (tre) vjet.

### DISPOZITA TË FUNDIT

1. Mosmarrveshjet gjatë zbatimit të kësaj kontrate zgjidhen me mirëkuptimin e paleve, në të kundërt ato zgjidhen në Gjykatën Administrative të Rrethit Gjyqësorë, Lushnjë.
2. Kjo kontratë hartohet në 3 (tre) kopje, dy prej të cilave i mban qiradhënësi dhe një qiramarrësi i kullotës dhe i veprave të ujit dhe shërbimit të saj.

**QIRAMARRËSI**

\_\_\_\_\_

**QIRADHËNËSI  
DREJTOR I DBPKU**

**Ilia Gjika**

\_\_\_\_\_

**LISTA EMERORE E KULLOTAVE TË GATSHME PËR KULLOTJE E KOSITJE, NË BASHKINË HIMARË  
PËR SEZONIN KULLOSOR 2025**

Nr.	Ekonomia Pyjore / Kullosore	Nr. ng.
1	E. K. Heremec	10, 11, 13/1, 14/1, 15
2	E. P. Bregdet	68, 57, 72, 77, 96, 97, 101, 102a, 103 a, 107, 108, 109, 110, 111, 117, 118
3	E. K. Bregdet	2, 3, 4, 5, 25, 26/1, 27/1, 28, 29, 33 1, 34 1, 35 1, 36 1, 37, 38/1, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54
4	E. P. Mali i Çikës-Himarë	6, 7/b, 37, 38, 40, 57 a, 3, 7/a, 40 a, 49, 50, 61 a
5	E. P. Gjomollë	1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18 a, 18/b, 19/a, 19/c, 20 a, 21 a, 22 a
6	E. P. Mali Pilurit Çikë	20, 23, 26, 27, 101, 102
7	E. K. Pilur Qepuro	5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28
8	E. K. Gjormë- Vranisht	19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32
9	E. P. Papadhi Çipin	22, 23, 43 ab, 48, 49, 50, 104, 107, 109, 133, 137, 138, 143
10	E. K. Kuç Mesaplik	1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23
11	E. K. Dhermit-Vuno	1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 1061/prot.

Himarë, më 11.02. 2025

**Lënda:** Dërgohet për njohje urdhri “Për ngritjen e komisionit të mbrojtjes civile në Bashkinë Himarë”.

**PREFEKTIT TË QARKUT VLORË**

Adresa: Lagjja. "Hajro Çakëri", Rruga. "Sulejman Delvina", Vlorë

**KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË**

✓ (këtu)

**KOMISARIATIT TË POLICISË HIMARË**

Adresa: Himarë

**ZYRËS VENDORE TE ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Adresa: Rr. “7 Nëntori”, Nr. 542, Vlorë

**DREJTORIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, BASHKIA HIMARË**  
(këtu)

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional si dhe në zbatim të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, paragrafi 1.1, shkronja b) dhe nenit 29, pika 1 dhe 2, të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, (të ndryshuar), nenit 9, pika 2 dhe 5, nenit 11, nenit 14, pika 2, 6 dhe 7, nenit 27, shkronja b), nenit 29, pika 2 dhe 3, dhe nenit 30 të ligjit Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM-së Nr.807, datë 28.12.2023 “Për miratimin e planit kombëtar për emergjencat civile”, ju përcjellim me qëllim vënien në dijeni, urdhrin nr.22 datë 29/01/2025 “Për ngritjen e komisionit të mbrojtjes civile në bashkinë Himarë”.







REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
**BASHKIA HIMARË**  
**KRYETARI**

Nr. 1061 prot.

Himarë, më 29.01 . 2025

**URDHËR**

Nr. 22 , datë. 29.01.2025

**PËR**

**“NGRITJEN E KOMISIONIT TË MBROJTJES CIVILE NË BASHKINË HIMARË”**

Në mbështetje të Nenit 8, pika 2, Nenit 9, pika 1, paragrafi 1.1, shkronja b) dhe Nenit 29, pika 1 dhe 2, të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, (të ndryshuar), nenit 9, pika 2 dhe 5, nenit 11, nenit 14, pika 2, 6 dhe 7, nenit 27, shkronja b), nenit 29, pika 2 dhe 3, dhe nenit 30 të ligjit Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM-së Nr.807, datë 28.12.2023 “Për miratimin e planit kombëtar për emergjencat civile”;

**URDHËROJ:**

1. Për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe realizimin e mbrojtjes civile në territorin e Bashkisë Himarë, të ngrihet dhe të funksionojë Komisioni i Mbrojtjes Civile (KMCB), në nivel bashkie.
2. Komisioni i Mbrojtjes Civile të kryesohet nga Kryetari i Bashkisë me këtë përbërje:

**Funksioni në KMC**

- |  |                      |
|--|----------------------|
| 1. Kryetari i Bashkisë   | Kryetar i Komisionit |
| 2. Nënkryetari i Bashkisë,   | Zv/kryetar i KMC     |
| 3. Sektori i emergjencave civile, (drejtuesi)                        | Sekretar i KMC       |
| 4. Komisariati i Policisë Himarë, (drejtuesi)                        | Anëtar               |
| 5. Përfaqësues nga Këshilli Bashkiak Himarë                          | Anëtar               |
| 6. Drejtoria e planifikimit dhe zhillimit të territorit, (drejtuesi) | Anëtar               |
| 7. Drejtoria e Bujqësisë, pyjeve, kullotave dhe ujitjes (drejtuesi)  | Anëtar               |
| 8. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (drejtuesi)                | Anëtar               |

përmirësime për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore e të mjedisit.

dh. Bazuar në Strategjinë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë dhe në Strategjinë Vendore të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë të bashkisë Himarë dhe veçanërisht në përcaktimet rreth detyrave të Komisionit të Mbrojtjes Civile në nivel bashkie, të Planit Kombëtar për Emergjencat Civile, të planit të Emergjencave Civile në qarkun Vlorë dhe të bashkisë Himarë të planifikojë, organizojë, koordinojë dhe kontrollojë të gjithë masat për parandalimin/lehtësimin, gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë në territorin e bashkisë dhe të sigurojë bashkërendimin e të gjitha aktiviteteve të strukturave shtetërore dhe jo shtetërore në bashki për këtë qëllim.

e. Të shqyrtojë dhe të analizojë funksionimin e sistemit të monitorimit, të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në territorin e bashkisë, dhe sipas rastit të marrë masa për përmirësimin e tij.

ë. Të shqyrtojë, të rekomandojë, të përgatisë programe edukimi dhe veprimtari trajnuese në fushën e mbrojtjes civile për përgatitjen e personelit që angazhohet në raste fatkeqësish dhe për edukimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit.

f. Në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe degët territoriale, Prefektin e qarkut, organizatat e ndryshme ndërkombëtare, subjektet private, shoqatat dhe organizatat e shoqërisë civile, si dhe ekspertët privatë, të kryejë:

- Deri në fund të muajit Maj 2025, vlerësimin e risqeve nga fatkeqësitë në territorin e bashkisë Himarë dhe dokumentin e hartuar ta dërgojë për miratim në Këshillin Bashkiak, si dhe rishikimin e këtij dokumenti nga ana e tij jo më pak se një herë në çdo tre vjet.

- Brenda vitit 2025 hartimin e strategjisë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë në nivel bashkie dhe dërgimin e dokumentit të hartuar për miratim në Këshillin Bashkiak, si dhe rishikimin e këtij dokumenti nga ana e tij jo më pak se një herë në çdo pesë vjet.

- Brenda vitit 2025 përgatitjen e planit vendor për emergjencat civile dhe dërgimin e dokumentit të hartuar për miratim në Këshillin Bashkiak, si dhe rishikimin e këtij dokumenti nga ana e tij jo më pak se një herë në çdo tre vjet.

g. Të bashkëpunojë me Komisionin e Mbrojtjes Civile në nivel Qarku dhe komisionet përkatëse të bashkive fqinje, me qëllim bashkimin e kapaciteteve të tyre për trajtimin e çështjeve të përbashkëta në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe të mbrojtjes civile.

gj. Të bashkërendojë veprimtaritë për organizimin dhe pajisjen e forcave të ndërhyrjes në rastet e fatkeqësive.

h. Të ndjekë dhe të zbatojë të gjitha detyrat e tjera në rastet e fatkeqësive, si në rastet e shpalljes dhe ato të mos shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

- mjetet e informimit, zonat e mbrojtjes dhe vendstrehimet e sigurta.
- Ndërgjegjësimin e komunitetit për ruajtjen e ushqimit të nevojshëm, të ujit dhe të rezervave të tjera minimale.
6. Sekretari i komisionit përgatit të gjitha materialet e mbledhjeve të radhës së komisionit, mban procesverbalet e takimeve dhe i ndan ato me anëtarët e komisionit.
  7. Funksionimi i Komisionit të Mbrojtjes Civile përcaktohet sipas rregullores për këtë qëllim të miratuar në këtë Komision.
  8. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

Vangjel Tavo

